Universum International College
Powered by Arizona State University

KOMUNA E LIPJANIT

Nr. 18146/1
Data: 25/11/2024

Donacion për dhurimin e librave për Drejtorinë së Arsimit në Lipjan

UNI-Universum International College në mbështetje të zhvillimit të arsimit dhe edukimit në Komunën e Lipjanit, duke u bazuar në misionin e saj për promovimin e arsimit, përkrahjes dhe edukimit cilësor, merr këtë:

VENDIM

1. Dhuron një sasi të librave të përzgjedhur për Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Lipjanit, me qëllim të pasurimit të fondit të literaturës në shkollat lokale dhe përmirësimit të cilësisë së edukimit.

2. Librat përfshijnë tituj nga fusha të ndryshme si: letërsia, shkenca, teknologjia, edukimi qytetar dhe materiale referuese për mësimdhënësit dhe nxënësit.

3. Librat e dhuruar do të dorëzohen fizikisht në Drejtorinë e Arsimit Lipjan; gjegjësishtë në bibliotekën e shkollës,

4. Pas procesit të inventarizimit, librat do të shpërndahen në shkollat e komunës sipas një plani të përcaktuar nga Drejtoria e Arsimit, duke marrë parasysh nevojat specifike të çdo institucioni arsimor.

5. "**Uni-Universum International College** shpreh përkushtimin e saj për bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet lokale të arsimit në Komunën e Lipjanit për përmirësimin e kushteve dhe çasjes në materiale edukative.

6. Shpreh mirënjohjen dhe falënderimet e saj **Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Lipjanit** për bashkëpunimin e treguar në realizimin e këtij donacioni.

7. Për transparencë dhe informim të opinionit publik, ky vendim do të publikohet në faqen zyrtare të "UNI-Universum International College dhe të Komunës së Lipjanit.

8.Palët zotohen që të bashkëpunojnë tutje në promovimin e arsimit, dhe aktiviteteve që UNI-Universum International College që do të zhvillojë në shkollat e Komunës së Lipjanit.

Valon Murati
ZV.President për Marrëdhënie me Jashtë

Rasim Hasani
Drejtor i Arsimit ; Komuna Lipjan